



VENDIM

Nr. 62 Datë 22.07.2011

**PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR SHËRBIMIN E VERIFIKIMIT,
KONTROLLIT FILLESTAR DHE PERIODIK TË MATËSAVE TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 51 pika 9 të Ligjit nr. 9072 date 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, i ndryshuar nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.07.2011, mbasi shqyrtoi draftin e propozuar nga DPM-ja dhe përpunuar nga grupi i punës, për kontratën Tip për shërbimin e verifikimit, kontrollit fillestar dhe periodik të matësive të energjisë elektrike

Vendosi:

1. Të miratojë kontratën Tip për shërbimin e verifikimit, kontrollit fillestar dhe periodik të matësive të energjisë elektrike. (bashkëlidhur këtij vendimi)
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektin e interesuar për vendimmarrjen e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-s
Sokol RAMADAN**